

VENDIM
Nr. 95/2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 166,
DATË 16.12.2004, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KUVENDIT TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 75, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 117 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh nga pozita parlamentare, si dhe të një grupi deputetësh nga opozita parlamentare,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në Rregulloren e Kuvendit, miratuar me vendimin nr. 166, datë 16.12.2004, “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 20, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Deputeti është anëtar vetëm i një komisioni të përhershëm. Deputeti mund të marrë pjesë në mbledhjet e komisioneve të tjera, por pa të drejtë vote.”.

Neni 2

Në nenin 47 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Titulli ndryshohet si më poshtë:

“E drejta e fjalës për anëtarët e Këshillit të Ministrave”.

b) Pas pikës 1/1 shtohet pika 1/2 me këtë përmbajtje:

“1/2. Kur e merr fjalën Kryeministri, ka të drejtë të bëjë komente menjëherë pas tij edhe kryetari i grupit parlamentar më të madh të opozitës, ose një përfaqësues i caktuar prej tij, për të njëjtën kohë sa ajo e Kryeministrit.”.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 27.11.2014